REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6
TEL: 693645101

# PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

**Nr. repertori: 5688** **Nr. koleksioni: 3628**

**Tirane më 26/09/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A20220514003974417 57

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë

A20220514003974I757

# AKT THEMELIMI

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## "GEOMETRIX PRO" Sh.p.k.

## KAPITULLI I

## FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

### NENI 1 – FORMA

1.1. Është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "Geometrix Pro" Sh.p.k., (në vijim "Shoqëria"), veprimtaria e së cilës rregullohet me anë të këtij Akt Themelimi dhe Statuti.

1.2. Ky Akt Themelimi, është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.

1.3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

### NENI 2 – EMERTIMI

2.1 Emërtimi i Shoqërisë është "**Geometrix Pro**" Sh.p.k.

### NENI 3 – OBJEKTI I SHOQERISE

3.1 Shoqëria do të kryejë si objekt të veprimtarisë së saj:

- " *Studim – Projektim- Mikqyrje - Kolaudim, KonsulenceTeknike, nendertim e zbatim te veprave inxhinierike ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit ne fuqi. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban, projektim arkitektonik, projektim strukturash betonarme, metalike, projektim autostrada heliporte dhe aeroporte. Projektim, ndertim montim, zbatim e rikostruksion te godinave te te gjitha llojeve, rruge te cdo kategorie, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, punime nentokesore, ura e vepra arti, ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, veprakullimi e vaditje, ndertime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime, barrier dhe mbrojtje lumore diga, damba, tunele.*

*- Studim – Projektim - Mikqyrje - Kolaudim, KonsulenceTeknike, ne ndertimin e stacione elektrike, linja te tensionit te larte, te ulet e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Ndertimehidrosanitare, kuzhina, lavanteri e mirembajtjen e tyre. Impjantengritesetransportuese. Ndertimeparafabrikat, betonarme, strukturametalike e druri. Impjanteteknologjike, termike e kondicinimi. Impjante e linjatelefoniedhetekomunikacioni. Impjantetebrendshmeeletrike, telefonike, radiotelefonietj. Impjantetesinjalistikesrrugoretetrafikut, sinjalistikarrugore jo ndricuese. Investime ne ndertimecivile, pallate, ne ndertimturistike.*

*- Projektim fotogrametik, hartografik, topografik, konsulenca tekniko-ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi qe nuk permendet me siper. Menaxhim dhe koordinim I projekteve te ndryshme, konsulenca te ndryshme ne lidhje me sherbimet e mesiperme.*

*- Agjensi imobilare per ndermjetesi dhe tregtimin te pasurive te luajtshme e te paluajtshme, shit blerjen e tokes, treg. e mallrave te gatshem e gjysem te gatshme , transaksione ne burse, shitblerje letrash me vlere etj per vete dhe per te trete. Agjensi turistike per transport mallrash e udhetaresh. Pika servisi per automjetet. Import-eksport sipas legjislacionit. Ndermarje ndertimi per vete dhe per tetrete ne kryrjen e veprimtarive ndertimore, ndertime civile, industriale, bujqesore, turistike dhe kompletimi me instalimetelektrike, elektronikeetj. qelidhen me to.*

*- Vleresim te pasurive te paluajtshme dhe objekteve industriale.*

*- Analiza per industri te ndryshme, analizim i strukturave operative financiare. Studim fisibiliteti tekniko-financiar te projekteve dhe shoqerive. Plane Bisnesi per projekte investimi, shoqeri tregtare etj.*

*- Ekspert privat zjarrfikes.*

*- Sherbime Espertize dhe/ ose Profesionale lidhur me Burimet Energjitike.*

*- Import eksport, shitje dhe blerje automjetesh per mallra dhe pasagjere".*

NOTER TIRANË

A202205140039744175?

Gjithashtu shoqëria do të zhvillojë aktivitete të tjeta në lidhje me veprimtarinë e sipër përmendur të lejuar nga Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

## NENI 4 – SELIA

4.1. Selia e Shoqërisë është: Tirane, Rruga "Ali Visha ", Pallati 13 , Apartamenti 84 , Shkalla 5 .

*Email: info@geometrixpro.al.*

4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

4.3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë edhe jashtë saj.

## NENI 5 – KOHEZGJATJA E VEPTIMTARISE

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë deri ne 31 Dhjetor 2092.
5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## KAPITULLI II

## KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

## NENI 6 – KAPITALI THEMELTAR

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lek ( njëqind mije leke).
6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, e gjithe e nënshkruar dhe e paguar, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë, përcaktuar në nenin 7 të këtij Statuti.

## NENI 7 – KONTRIBUTET DHE KUOTAT

7.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:

- Ortaku themelues **Z.ARKEL BELLO**, atësia Vilson, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë Lagja Nr 4; Nd. 199; Sarandë; Sarandë; 9701; Sarandë, lindur më 19/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035946400 dhe nr. personal J10819113F, zotërues i një (1) kuote me vlerë të barabartë me 50.000 Lek ( pesedhjete mije leke) që përbën 50 % (pesedhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Ortaku themelues **ZNJ.MARINELA LAMÇE**, atësia Lefter, amësia Olimbi, shtetase Shqiptare, lindur në Divjakë, Lushnjë dhe banuese në TIRANË, me adresë Ali Visha; Nd. 17; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 29/04/1990, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035813683 dhe nr. personal J05429063M, zotërues i një (1) kuote me vlerë të barabartë me 50.000 Lek ( pesedhjete mije leke) që përbën 50 % (pesedhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## NENI 8 – RRITJA E KAPITALIT THEMELTAR

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
8.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë.

## NENI 9 – ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali

A2022051400397441757

themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
9.2 Format dhe mënyrat e tjera të ushtrimit të drejtës në lidhje me rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve dhe lejimeve të ligjit tregtar.

### NENI 10 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve sipas përcaktimeve të ligjit për shoqëritë tregtare.
10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje ose me email zyrtar të secilës prej palëve, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e bleresit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet kuotës të ofruar për shitje.
10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande ose njoftimit me anë të emailit zyrtar të palëve, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes dhe transferimi i kuotës kryhet lirisht tek të tretët.
10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon ate, do të ndahet midis ortakëve pranues, proporcionalisht me vleren nominale te kuotes se kapitalit qe ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

## KAPITULLI III

## ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

### NENI 11 – ASAMBLEJA E PERGJITHSHME DHE KOMPETENCAT E SAJ

11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese sipas përcaktimeve të ligjit për shoqëritë tregtare: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës në fuqi.

### NENI 12 – TE DREJTAT E PJESEMARRJES DHE E VOTES

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota ne proporcion me vlerën nominale te kuotës se kapitalit që ai zotëron.
12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, i pajisur me autorizim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kuotës që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

### NENI 13 – THIRRJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME, KUORUMI DHE VENDIMET

13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar, për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve ose me poste elektronike dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.
13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në

pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjete përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% pesëdhjete e një për qind) të kapitalit themeltar.

13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të ¾ (tre të katërtat) e ortakëve te pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesedhjete e një përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjete përqind) të kapitalit themeltar.

13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

## NENI 14 – ADMINISTRIMI

14.1 Administrator i Shoqerise do te zgjidhet **Z.Arkel Bello.** Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar. Veprimet të cilat tejkalojnë objektin e kompetencës sipas këtij neni, janë të pavlefshme në qoftë se nuk kanë miratimin e të gjithë ortakëve.

14.3 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

14.4 Në rast se shoqëria administrohet më shumë se nga një administrator gjatë veprimtarisë së saj, administratorët mund të kenë kufizime tagrash bazuar në vendimin përkatës së Asamblesë së Përgjithshme. Këto kufizime do të pasqyrohen dhe do ti bëhen të njohur dhe palëve të treta nëpërmjet regjistrimeve përkatëse.

## NENI 15 – EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.

15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet ne cdo kohe sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacionit në fuqi.

## KAPITULLI IV

## VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

## NENI 16 – VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji ntr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

## NENI 17 – FITIMET

17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me vleren nominale te quotes se kapitalit themeltar të zotëruar.

17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të

A2022051400397441757

tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

## KAPITULLI V

## SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

### NENI 18 – PRISHJA

18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

### NENI 19 – LIKUIDIMI

19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.

19.2 Për të administruar këtë proçedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me vleren nominale te kuotës të zotëruar prej tyre në kapitalin themeltar.

### NENI 20 – ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij akt themelimi si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### NENI 21 – GJUHA

21.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKET**

| | |
|---|---|
| **MARINELA LAMÇE** | **ARKEL BELLO** |
| Marinela Lamçe | Arkel Bello |

**NOTER**

**ALKET Z.MANÇKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ALKET Z.MANÇKA NOTER TIRANË

A2022051400397441757

# STATUT I SHOQERISE
## "GEOMETRIX PRO" Sh.P.K.

Sot, me 26/08/.2022 personat e meposhtem:

1. **Z.ARKEL BELLO,** atësia Vilson, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë Lagja Nr 4; Nd. 199; Sarandë; Sarandë; 9701; Sarandë, lindur më 19/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035946400 dhe nr. personal J10819113F.
2. **ZNJ.MARINELA LAMÇE,** atësia Lefter, amësia Olimbi, shtetase Shqiptare, lindur në Divjakë, Lushnjë dhe banuese në TIRANË, me adresë Ali Visha; Nd. 17; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 29/04/1990, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID nr. 035813683 dhe nr. personal J05429063M.

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, ka miratuar kete Statut si vijon:

## KAPITULLI I
## THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

### Neni 1
### Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte **"GEOMETRIX PRO" Sh.P.K.**

Shoqeria **"GEOMETRIX PRO" Sh.P.K.** eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (me pas refeuar si "**Ligji Tregtar**") ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Regjsitrimit (me pas refeuar si "**QKR**") ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

### Neni 2
### Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: Selia e Shoqërisë është: Tirane, Rruga "Ali Visha ", Pallati 13 , Apartamenti 84 , Shkalla 5. *Email: info@geometrixpro.al.*

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

### Neni 3
### Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:

- *Studim – Projektim- Mikqyrje - Kolaudim, KonsulenceTeknike, nendertim e zbatim te veprave inxhinierike ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit ne fuqi. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban, projektim arkitektonik, projektim strukturash betonarme, metalike, projektim autostrada heliporte dhe aeroporte. Projektim, ndertim montim, zbatim e rikostruksion te godinave te te gjitha llojeve, rruge te cdo kategorie, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, punime*

A2022051400397441757

*nentokesore, ura e vepra arti, ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, veprakullimi e vaditje, ndertime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime, barrier dhe mbrojtje lumore diga, damba, tunele.*

*- Studim – Projektim - Mikqyrje - Kolaudim, KonsulenceTeknike, ne ndertimin e stacione elektrike, linja te tensionit te larte, te ulet e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Ndertimehidrosanitare, kuzhina, lavanteri e mirembajtjen e tyre. Impjantengritesetransportuese. Ndertimeparafabrikat, betonarme, strukturametalike e druri. Impjanteteknologjike, termike e kondicinimi. Impjante e linjatelefoniedhetekomunikacioni. Impjantetebrendshmeeletrike, telefonike, radiotelefonietj. Impjantetesinjalistikesrrugoretetrafikut, sinjalistikarrugore jo ndricuese. Investime ne ndertimecivile, pallate, ne ndertimturistike.*

*- Projektim fotogrametik, hartografik, topografik, konsulenca tekniko-ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi qe nuk permendet me siper. Menaxhim dhe koordinim I projekteve te ndryshme, konsulenca te ndryshme ne lidhje me sherbimet e mesiperme.*

*- Agjensi imobilare per ndermjetesi dhe tregtimin te pasurive te luajtshme e te paluajtshme, shit blerjen e tokes, treg. e mallrave te gatshem e gjysem te gatshme , transaksione ne burse, shitblerje letrash me vlere etj per vete dhe per te trete. Agjensi turistike per transport mallrash e udhetaresh. Pika servisi per automjetet. Import-eksport sipas legjislacionit. Ndermarje ndertimi per vete dhe per tetrete ne kryrjen e veprimtarive ndertimore, ndertime civile, industriale, bujqesore, turistike dhe kompletimi me instalimetelektrike, elektronikeetj. qelidhen me to.*

*- Vleresim te pasurive te paluajtshme dhe objekteve industriale.*

*- Analiza per industri te ndryshme, analizim i strukturave operative financiare. Studim fisibiliteti tekniko-financiar te projekteve dhe shoqerive. Plane Bisnesi per projekte investimi, shoqeri tregtare etj.*

*- Ekspert privat zjarrfikes.*

*- Sherbime Espertize dhe/ose Profesionale lidhur me Burimet Energjitike.*

*- Import eksport, shitje dhe blerje automjetesh per mallra dhe pasagjere."*

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.
Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

**Neni 4**
**Kohezgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë deri ne 31 Dhjetor 2092. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## KAPITULLI II
## KAPITALI – KUOTAT

**Neni 5**
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lek ( njëqind mije leke). Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota qe jane paguar e zoterohen teresisht nga ortaket themelues si vijon:

- Ortaku themelues **Z.ARKEL BELLO**, atësia Vilson, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë Lagja Nr 4; Nd. 199; Sarandë; Sarandë; 9701; Sarandë, lindur më 19/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035946400 dhe nr. personal J10819113F, zotërues i një (1) kuote me vlerë të barabartë me 50.000 Lek ( pesedhjete mije leke) që përbën 50 % (pesedhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Ortaku themelues **ZNJ.MARINELA LAMÇE**, atësia Lefter, amësia Olimbi, shtetase Shqiptare, lindur në Divjakë, Lushnjë dhe banuese në TIRANË, me adresë Ali Visha; Nd. 17; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 29/04/1990, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035813683 dhe nr. personal J05429063M, zotëruese e një (1) kuote me vlerë të barabartë me 50.000 Lek ( pesedhjete mije leke) që

përbën 50 % (pesedhjete përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku eshte pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

**Neni 6**
**Kuotat**
**Te drejtat dhe detyrimet e lidhura**

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve ("**Regjistri i Ortakeve**").

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

**Neni 7**
**Transferimi i Kuotave**

7.1. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjithe apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjithe apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.

7.2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithe apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t`u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.

7.3. Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.

7.4. Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.

7.5. Administratoret brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.

7.6. Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.

7.7. Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak si me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuoten e tij do te jete i lire t'ia transferoje kete kuote personit/ave te percaktuar prej tij.

7.8. Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuoten objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit 1 (nje) mujor te percaktuar me siper.

7.9. Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

**Neni 8**
**Zmadhimi i Kapitalit**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes

brenda 20 (njezet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.
Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

**Neni 9**
**Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

## KAPITULLI III
## ORGANET E SHOQERISE

**Neni 10**
**Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

a. percaktimi i politikave tregtare;
b. ndryshime te Statutit;
c. emerimi i Administratoreve;
d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.
Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.
Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katermbedhjete) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.
Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.
Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.
Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

A2022051400397441757

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.
Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

**Neni 11**

**Organi Administrues / Administratoret**

Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.
Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i vetem i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

- **Z.Arkel Bello.**

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.
Administratori do te:

(i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
(ii) perfaqesoje Shoqerine;
(iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
(iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
(v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
(vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
(vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
(viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
(ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizoje persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar katergorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje.
Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

A2022051400397441757

**Neni 12**

**Kontrolli i Shoqerise**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

## KAPITULLI IV
## VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

**Neni 13**

**Viti Financiar**

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

**Neni 14**

**Rezerva Ligjore**

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

**Neni 15**

**Dividendet**

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

## KAPITULLI V
## PRISHJA - LIKUIDIMI

**Neni 16**

**Prishja e Shoqerise**

Shoqeria prishet (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

**Neni 17**

**Likuidimi**

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

**Neni 18**

**Dispozita Perfundimtare**

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari tjeter nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

*Për ndjekjen e të gjithë procedurave në lidhje me regjistrimin fillestar të Shoqërisë dhe akteve përkatëse në Regjistrin Tregtar (QKB) Z.Arkel Bello, mund të paraqitet e veprojë veçmas apo së bashku me të drejta e kompetenca të plota për nënshkrimin dhe dorëzimin e çdo aplikimi, kërkese dhe/ose dokumenti që konsiderohet se duhet paraqitur pranë Regjistrit Tregtar për kompletimin e regjistrimit.*

A2022051400397441757

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhet Shqipe.

**ORTAKET THEMELUES**

**MARINELA LAMÇE**

**ARKEL BELLO**